



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prenyeno / Prudato Received / Delivety	12.04	2023	3	veti qant ynori
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINSACK	3489/2023		119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.426/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.426/2023 të datës 27.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër KD.nr.054/2023 i datës 23.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.426/2023 e datës 27.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KD.nr.054/2023 i datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesit i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 23.02.2023 ka parashtruar ankesë përmes postës, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 27.02.2023 dhe është regjistruar me Nr. Prot: 2133/2023, kundër Vendimit me numër KD.nr.054/2023 i datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të ligjit

material, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuesit si të bazuar ndërsa të shfuqizojë Vendimit me numër KD.nr.053/2023 i datës 23.01.2023 të Komisionit Disiplinor

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 16.03.2023 ka pranua nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:2739/2023, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:2133/2022 të datës 27.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.054/2023 i datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin e Komisionit Disiplinor i datës 13.12.2022 me shifër KD/053/13/12/2022; E-mailin e datës 13.12.2022 dërguar nga ankuesi për S.G; Njoftimin e datës 13.12.2022 dërguar nga ankuesi për S.G; E-mailin e datës 13.12.2022 dërguar nga M.M për A.Sh; Shkresën "Akt mbi dorëzimin - pranimin e dokumenteve shkresave të lëndës QPGJL 908-22" e datës 13.12.2023; Zarin postar me shifër R2776285 i datës 23.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; Përgjigjen në kërkesë me shkresat e lëndës e datës 16.03.2023; Akt emërimit e ankuesit i datës 12.07.2022; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 13.12.2022; Ftesë për intervistë e datës 18.01.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e Zv. Drejtorit në QP Gjilan; Vendimin e datës 10.01.2023 të Komisionit Disiplinor; Procesverbalet e seancës së datës 20.01.2023

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.426/2023 e datës 27.02.2023, e parashtruar nga ankuesi është e **pabazuar**, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi Fidan hasani sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.065/2022 të datës 12.07.2022 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit-Qendra e Paraburgimit Gjilan", ndërsa ndaj të njëjtit me datë 13.12.2022 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka iniciuar procedurën disiplinore me pretendimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor pas pranimin të kërkesës për inicimin të procedurës disiplinore, fillimisht ka nxjerrë Vendimin e datës 13.12.2022 përmes të cilit ankuesin e ka pezulluar nga puna me pagesë 50% të pagës deri në nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër por jo më shumë se gjashtë (6) muaj, sikurse me datë 10.01.2023 Komisioni Disiplinor ka nxjerrë Vendimin KD.nr.054/2022 duke ia shtyrë afatin e vendimmarrjes procedurës disiplinore edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë, ndërsa me datë 23.01.2023 ka nxjerrë Vendimin KD.Nr.054/2023 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim i 20% pagës për periudhën një (1) muaj" me arsyetimin se i njëjti është përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 3 pika 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, pasi që ankuesi në cilësi të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, në rastin e vetëvrasje së të burgosurit B.H është gjetur përgjegjës për shkak

të lëshimeve të ushtrimit detyrave funksionale në cilësi të zëvendës drejtorit të qendrës korrektuese.

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *"Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë"*, nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeslicaionit të veçantë, gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1.Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës"* ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 3 pika 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës ku përcaktohet se: *"Përveç shkeljeve të parapara në Ligjin për Zyrtar Publikë, personeli i SHKK-së përgjigjen edhe për shkeljet disiplinore të veçanta. 3. Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 3.12. mosveprimi në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës"* si dhe ka analizuar përkrahimin e detyrave të punës së ankuesit ku ndër të tjera përcaktohet se është: *Detyra Kryesore-në mungesë të drejtorit siguron menaxhimin gjithëpërfshirës të Qendrës së Paraburgimit; Siguron informimin dhe interpretimin e parimeve dhe procedurave operative dh të sigurisë; Mbikëqyrë personelit drejtpërdrejtë apo përmes vartësve të tij; Kryen Inspektive ditore në të gjitha hapësirat e Qendrës së paraburgimit; Verifikon të gjitha standardet e burgut përfshirë sigurimin , duke i raportuar drejtorit... etj"*, dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesi në cilësi të *"Zëvendës Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit-Qendra e Paraburgimit Gjilan"* përveç tjerash ka përgjegjësi të përgjithshme menaxheriale në rastet kur mungon drejtori, ka përgjegjësi lidhur me inspektimin për çështjen e sigurisë, përgjegjësi të mbikëqyrjes së personelit si dhe ka përgjegjësi të verifikimit të standardeve të burgut në kuadër të Institucionit Korrektues që vepron dhe i njëjti mban përgjegjësi në rast se nuk vepron në pajtueshmëri me përgjegjësitë dhe detyrat funksionale të pacaktuar me nenin 25 të ligjit të veçantë për Shërbimin Korrektues Ligjit Nr.08/L-131.

Kolegji i Këshilli nga shkresat e administruara të lëndës dhe analizimit të dispozitave ligjore ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit *"ndalim i 20% pagës për periudhën një (1) muaj"* i përcaktuar me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj personelit SHKK-së, janë: 1.2. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në katër dhjetë për qind (40%) e pagës për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj"* dhe nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj"*, ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, ngase fillimisht pasi që në ditën kur ka ndodhur rasti i vetëvrasjes i të burgosurit B.H, sipas Raportit të datës 13.12.2022 të Komisionit Hetimor të SHKK-së, Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan nuk ka qenë fare prezent në institucion dhe për një çështje tillë nuk e kishte njoftuar askënd në hierarki më të lartë raportuese

se po largohet nga vendi i punës me qëllim që të shkoj për ngushëllime tek një kolegë, gjegjësisht Qendra e Paraburgimit në Gjilan kishte mbetur pa udhëheqës dhe mbikëqyrës të lartë ngase njëri nga mbikëqyrësit që ishte në ndërrim kishte shkuar të marrë pjesë për ngushëllime tek një kolegë së bashku me Drejtorin e Qendrës së Paraburgimit dhe që të dy janë gjetur përgjegjës, prandaj ankuesi duke ditur që institucioni në ditën e rastit kur kishte ndodhur vetëvrasja kishte mbetur pa mbikëqyrës të lartë, gjegjësisht i vetmi mbikëqyrës (*ankuesi*) që ka qenë në detyrë është angazhuar me detyra në Komision për Pranimin e Naftës, nga rrjedh se ankuesi sipas përshkrimit të detyrave funksionale të punës të përshkruara si më lartë përveç tjerash në mungesë të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit ka pasur gjithë barrën e përgjegjësisë funksionale të Institucionit Korrektues, madje këto të gjetura dhe as konstatimet e Komisionit Disiplinor ankuesi nuk ka mundur t'i kundërshtoj me prova bindëse as përmes ankesës së datës 27.02.2022 të parashtruar në Këshill.

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit ka vepruar drejtë pasi që i njëjti me rastin e shkelje së detyrave funksionale të punës ka konsumuar elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, prandaj ankesa e ankuesit është refuzuar si e pabazuar ndërsa Vendimi me numër KD.nr.054/2023 i datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës është lënë në fuqi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.426/2023

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së